



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) më datë 29.09.2017 realizoi vizitë për rikontroll në SP Ohër, e cila kishte për qëllim kontrollin e implementimit të rekomandimeve të dhëna në raport nga vizita e rregullt e realizuar më datë 05.06.2013.

MPN-ja realizoi **vizitë të paparalajmëruar për rikontroll** në SP Ohër, në kuadër të mandatit dhe kompetencave të cilat burojnë nga Protokollin Fakultativ ndaj Konventës kundër Torturës dhe trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe Ligji për Avokatin e Popullit.

MPN-ja realizoi vizitë e cila u fokusua në disa konstatime negative nga Raporti i posaçëm i vitit 2013 dhe kontrole të zbatimit të rekomandimeve të dhëna për përmirësimin e gjendjeve dhe eliminimin e mangësive dhe rreziqeve të cilat do të mund të çonin deri në torturë ose trajtim tjetër brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Gjatë vizitës, MPN-ja adresoi rekomandim deri te Stacioni policor, që në hapësirat e ndalimit të instalohet sistemi i thirrjes (zile elektronike ose interfon), i cili do të ishte në funksion deri në ndërtimin e hapësirave të reja për ndalim. Gjatë vizitës për rikontroll, nga këqyrja në hapësirat e ndalimit, Ekipi i MPN-së konstatoi se është instaluar sistemi për thirrje në dy hapësirat, përkatësisht se janë vendosur interfonë funksional dhe sisteme për thirrje me taster, i cili e alarmon menjëherë hapësirën kujdestare.

Gjithashtu, gjatë vizitës së parë ishte dhënë rekomandimi për sigurimin e sistemit për ngrohje gjatë periudhës së dimrit, me të cilin do të arrihej temperatura konform standardeve të dëshiruara ndërkombëtare për vendet e privimit nga liria. Gjatë vizitës për rikontroll, Ekipi i MPN-së konstatoi se në hapësira akoma nuk është siguruar sistemi për ngrohje gjatë periudhës së dimrit, me të cilin do të arrihej temperatura në hapësira, në përputhje me standardet ndërkombëtare për vendet e privimit nga liria.

MPN-ja, gjatë vizitës së parë, dha rekomandime për Stacionin policor, që në rastet kur në stacionin policor ndalohet person me nivel të lartë të alkoolit, detyrimisht të thirret mjeku, me qëllim të veprimit parandalues në drejtim të mbrojtjes së shëndetit të personit të privuar nga liria.

Mekanizmi Parandalues Nacional, gjatë vizitës për rikontroll, nga këqyrja e zbatuar mbi dokumentacionin e plotë, i cili është pjesë e dosjeve personale të personave të ndaluar, si dhe nga këqyrja në librat për udhëheqjen e evidencës, konstatoi se ky rekomandim është implementuar, me atë se në Stacionin policor mjeku thirret në rastet e ndalimit të personave të alkoolizuar, personave tek të cilët vërehet nevoja për ndihmë mjekësore, si dhe në rastet kur vet personat e ndaluar e kërkojnë një gjë të këtillë.

Të vendoset kontroll i rregullt i drejtpërdrejtë dhe mbikëqyrje mbi personat e ndaluar si praktikë pozitive, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të personave të cilët janë privuar nga liria dhe kjo të evidentohet në një fletë-kontrolli të veçantë. Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se në hapësirat për ndalim janë instaluar kamera, përmes të cilave personat e ndaluar janë nën monitorimin e përhershëm gjatë kohës së ndalimit të tyre, kështu që edhe nuk ka fletë-kontrolli të veçantë për vizitat e kryera, por nëpunësit policorë e vizitojnë personin çdoherë kur ka nevojë të këtillë, qoftë me kërkesë të personit të ndaluar ose me iniciativë të tyre.

U dha rekomandim, që të drejtat e personave të ndaluar të vendosen në vend të dukshëm në hapësirat e ndalimit të personave, më saktësisht në formë të kopjes së fletës me format A4 të vendosur në anën e brendshme të derës, si dhe në zyrën e pranimit (zyra e përgjegjës të turnit). Ekipi i MPN-së, gjatë vizitës për rikontroll, konstatoi se në hapësirën e përgjegjës të turnit, lista me udhëzimet e të drejtave të personave të thirrur, të arrestuar, personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar, udhëzimet për të drejtat në fletë me format A4 janë vendosur nga ana e jashtme, në vend që të vendosen nga ana e brendshme.

Gjatë vizitës së parë, Stacionit policor iu dha rekomandimi që evidenca për personat e ndaluar të udhëhiqet me rregull, dosjet individuale (ndihmëse) t'i përmbajnë procesverbalet e nevojshëm me të cilët vërtetohet se personi është njoftuar me të drejtat e tij, si dhe në të njëjtat të respektohet rrjedhja logjike e ngjarjeve gjatë kohës së privimit fillestar nga liria. Mekanizmi Parandalues Nacional, nga këqyrja e realizuar, në një pjesë të dosjeve personale të personave të ndaluar, si dhe nga librat për udhëheqjen e evidencës, konstatoi se akoma ka lëshime në mënyrën e udhëheqjes së evidencës, në kuptimin e mungesës së dokumenteve të rëndësishme në vet dosjet (si për shembull, mungesa e Aktvendimit për ndalim), lëshime sa i përket shënimit të orës së ndalimit të personave ose shënimit të kohës së ndalimit në Librin për evidencë, i cili nuk korrespondon me kohën e cekur të ndalimit në Procesverbalin për ndalimin e personit.

U dha rekomandim se të dhënat e evidentuara gabimisht në regjistrat të mos fshihen me llak korrektues, por të fshihen me një vizë, me çka nga njëra anë vihet në dukje e dhëna pavlefshme, ndërsa nga ana tjetër njëkohësisht, e dhëna e këtillë do të jetë qartë e lexueshme. Gjatë vizitës për rikontroll, nga këqyrja e zbatuar në regjistra, u konstatua se tanimë nuk përdoret llaku korrektues për korigjimin e

gabimeve, por të dhënat e shënuara gabimisht në regjistrat për evidencë fshihen me një vizë dhe njëkohësisht mbeten të lexueshme.

Mekanizmi Parandalues Nacional, gjatë vizitës së parë konstatoi se Stacioni policor nuk disponon me buxhet me të cilin do të përfshiheshin shpenzimet për sigurimin e ushqimit për personat e privuar nga liria dhe lidhur me këtë drejtoi rekomandime deri te MPB-ja, që të sigurohet buxhet i veçantë me të cilin do të përfshihen shpenzimet për sigurimin e ushqimit të personave të privuar nga liria të cilët ndalohen në SP Ohër. Gjatë vizitës për rikontroll, Ekipi MPN-së, konstatoi se në Stacionin policor ende nuk ka buxhet të veçantë me të cilin do të mbulohehin shpenzimet për sigurimin e ushqimit të personave të privuar nga liria, të cilët ndalohen në SP Ohër dhe prandaj, në rastet kur ka nevojë, personat zyrtarë me mjete personale e sigurojnë ushqimin për personat e ndaluar.

MPN-ja, gjatë vizitës gjeti një person të ndaluar, me ç'rast zhvilloi bisedë me personin e mitur dhe prindin e tij, të cilët në stacionin policor ishin thirrur për shkak të dhënies së deklaratës në lidhje me veprën penale për të cilën ishte dyshuar i mituri. Në këtë kontekst, u theksua se i mituri dhe prindi i tij, para se ta jepte deklaratën, ishin njoftuar me arsyet dhe shkakun e thirrjes dhe gjithashtu ishin udhëzuar të thërrasin mbrojtës.

Ekipi i MPN-së, gjatë kohës së bisedës, u informua se prindi i personit të mitur ishte ndaluar në stacion disa javë para vizitës, ndërsa faktin e ndalimit, Ekipi i MPN-së e konfirmoi edhe përmes këqyrjes së zbatuar në evidencën e dosjeve personale të cilat udhëhiqen për personat e ndaluar. Gjatë kohës së bisedës, Ekipi i MPN-së u informua se personi i ndaluar, para se të vendoset në hapësirat e ndalimit, ishte udhëzuar gojarisht për të drejtat e tij (për ndalimin ta njoftoj personin e tretë, të thërres mbrojtës, t'i ofrohet ndihma mjekësore...). Personi i ndaluar, me kërkesë të tij, ishte kontrolluar nga mjeku, gjë e cila është evidentuar në mënyrë përkatëse në evidencë (regjistrat dhe dosjet individuale) dhe gjithashtu, i është siguruar ushqimi, meqë ndalimi ka zgjatur më shumë se 6 orë.

Si rezultat i vizitës së realizuar për rikontroll, Mekanizmi Parandalues Nacional përpiloi raport në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Stacionit policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë dhe rreziqet.